

PLANI LOKAL SOCIAL PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA 2025 – 2027 BASHKIA VLORE

Plani Lokal Social për Personat me Aftësi të Kufizuara në Bashkinë Vlorë është një iniciativë kyçe e zhvilluar në kuadër të zbatimit të Projektit «Mbështetja e personave me AK për të gëzuar të drejtat e plota për shërbime sociale në qytetin e Vlorës» Ky projekt u zbatua nga Shoqata «Ndihamoni Jetën» me mbështetjen e projektit rajonal “SMART Balkans – Shoqëria Civile për Vlera të Përbashkëta në Ballkanin Perëndimor” i zbatuar nga Centar za promociju civilnog društva (CPCD) në partneritet me Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) dhe Center for Research and Policy Making (CRPM) dhe i mbështetur financiarisht nga Ministria e Punëve të Jashtme të Norvegjisë (NMFA), duke synuar përmirësimin e cilësisë së jetës për personat me aftësi të kufizuara dhe ndërtimin e një shoqërie më gjithëpërfshirëse dhe të drejtë.

Plani Lokal për Personat me Aftësi të Kufizuara në Bashkinë Vlorë përqendrohet në një qasje të integruar dhe gjithëpërfshirëse, që përfshin ndërhyrje të koordinuara në të gjitha nivelet dhe për të gjitha grupmoshat. Ky plan synon të sigurojë akses në shërbime të specializuara, mbështetje sociale dhe mjedise të aksesueshme për të gjithë personat me aftësi të kufizuara, duke garantuar respektimin e të drejtave të tyre dhe përmirësimin e mirëqenies së tyre.

Me mbështetjen e partnerëve të ndryshëm dhe bashkëpunimin e ngushtë ndërmjet institucioneve publike dhe organizatave jofitimprurëse, Bashkia Vlorë është e angazhuar për zbatimin efektiv të këtij plani. Angazhimi i vazhdueshëm përfshin krijimin e një sistemi të qëndrueshëm dhe të integruar të shërbimeve sociale, rritjen e ndërgjegjësimit të komunitetit dhe përfshirjen aktive të personave me aftësi të kufizuara në proceset vendimmarrëse lokale. Ky përkushtim synon të krijojë një mjedis më të sigurt dhe gjithëpërfshirës për të gjithë qytetarët e Bashkisë Vlorë, duke siguruar që askush të mos lihet pas.

«Plani Lokal Social për Personat me Aftësi të Kufizuara në Bashkinë Vlorë» është zhvilluar me mbështetjen e projektit rajonal “SMART Balkans – Shoqëria Civile për Vlera të Përbashkëta në Ballkanin Perëndimor” të zbatuar nga Centar za promociju civilnog društva (CPCD) në bashkëpunim me Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM), dhe Qendra për Kërkim dhe Politikëbërje (CRPM) dhe i mbështetur financiarisht nga Ministria e Punëve të Jashtme të Norvegjisë (NMFA).

Përmbajtja e dokumentit “Plani Lokal Social për Personat me Aftësi të Kufizuara në Bashkinë Vlorë” është përgjegjësi e vetme e zbatuesve të projektit dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Ministrisë së Punëve të Jashtme Norvegjeze (NMFA)

Përmbajtja

Hyrje	4
1. Identifikimi i tipologjisë së nevojave	6
1.1. Të dhënat demografike të personave me aftësi të kufizuara në Bashkinë Vlorë	6
1.1.1 Numri i personave me aftësi të kufizuara në Bashkinë Vlorë sipas gjinisë, strukturës moshore me referencë fëmijë dhe të rritur, njësisë administrative dhe llojeve të aftësisë së kufizuar.	7
1.1.2 Numri i personave me aftësi të kufizuara që janë të punësuar.	9
1.1.3 Shërbimet shëndetësore në Bashkinë Vlorë për personat me aftësi të kufizuara	10
1.1.4 Sistemi i Edukimit dhe Kujdesit për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara në Bashkinë Vlorë.....	12
1.1.5 Buxheti njësisë vendore për aftësinë e kufizuar; Shpenzimet e kujdesit shoqëror (si përqindje e buxhetit vendor) dhe raportin që zë në këtë buxhet shpenzimet për shërbimet për personat me aftësi të kufizuara.	14
1.2 Profili dhe karakteristikat e përdoruesve të shërbimit	16
1.2.1 Burimet njerëzore dhe shërbimet për personat me aftësi të kufizuara;	16
1.3 Konsultimi i përdoruesve të shërbimit dhe i kujdestarëve të tyre në lidhje me nevojat.....	17
1.3.1 Aksesueshmërisë në institucionet e Bashkisë Vlorë	17
1.3.2 Nevoja e diversifikimit, shtrirjes gjeografike të shërbimeve për të gjithë grupet e aftësisë së kufizuar dhe niveli i ulët i ndërveprimit sektorial.....	27
2. Vlerësimi i niveleve aktuale të shërbimeve.....	29
2.1 Hartëzimi i shërbimeve.....	29
3. Plan lokal i veprimit për personat me aftësi të kufizuar 2025-2027	31
Referenca	53

Hyrje

Bashkia e Vlorës, një ndër qytetet më të rëndësishme të Shqipërisë, shtrihet përgjatë bregdetit të Adriatikut dhe Jonit në jugperëndim të vendit, rreth 135 km larg nga Tirana. Me një pozitë strategjike dhe peizazhe të pasura natyrore, Vlora është një destinacion i rëndësishëm turistik dhe ekonomik, që përfaqëson një pikë kyçe për zhvillimin rajonal dhe kombëtar. Kufijtë e saj përfshijnë bashkinë Fier në veri, Mallakastrën dhe Tepelenën në lindje, si dhe Sarandën e Gjirokastrën në jug. Qendra e bashkisë është qyteti i Vlorës, dhe ajo përbëhet nga katër njësi administrative kryesore: Orikumi, Qendra, Novosela dhe Shushica. Me një popullsi prej 188,922 banorësh (sipas të dhënave të 1 janarit 2020), Vlora është qyteti i dytë më i madh portual i Shqipërisë, pas Durrësit, duke luajtur një rol të rëndësishëm në tregtinë detare dhe transportin.

Sipas të dhënave të Bashkisë Vlorë për qershorin 2024, janë regjistruar 2,417 persona me aftësi të kufizuara të cilët përfitojnë shërbime financiare nga bashkia. Kjo përfshin një gamë të gjerë të grupeve të personave me aftësi të kufizuara, duke përfshirë 720 persona me invaliditet pune, 135 persona me aftësi të kufizuara në shikim, 73 para-tetraplegjikë, dhe 478 persona me aftësi të kufizuara intelektuale dhe fizike. Për më tepër, janë 221 persona që marrin pagesa për shërbimin e ndihmës personal, një shërbim i ri që ka zëvendësuar shërbimin tradicional të kujdestarisë. Kjo tregon një përpjekje të qartë për të avancuar në drejtim të ofrimit të shërbimeve të personalizuara dhe të përshtatura për personat me aftësi të kufizuara, duke synuar përmirësimin e pavarësisë dhe cilësisë së jetës së tyre.

Promovimi i të drejtave dhe përfshirja sociale e personave me aftësi të kufizuara kërkon një bashkëpunim të ngushtë midis shumë sektorëve dhe niveleve të qeverisjes, si në nivel lokal ashtu edhe qendror. Për të siguruar harmonizimin dhe zbatimin efektiv të politikave dhe shërbimeve, ndërhyrjet ndërsektoriale dhe ndërinstitutionale janë të domosdoshme. Kjo kërkon një koordinim të kujdesshëm dhe një angazhim të vazhdueshëm për të siguruar që të gjitha shërbimet dhe programet të jenë të aksesueshme, të përshtatshme dhe të respektueshme për nevojat e personave me aftësi të kufizuara. Sidoqoftë, vlerësimi i nevojave dhe respektimi i të drejtave të tyre mbetet një sfidë e vazhdueshme, duke kërkuar një presion të vazhdueshëm nga aktorët lokalë, kombëtarë dhe ndërkombëtarë.

Plani Social për Aftësinë e Kufizuar 2025-2027, i hartuar nga Bashkia e Vlorës me mbështetjen e organizatave të shoqërisë civile dhe institucioneve ndërkombëtare, është një dokument strategjik që synon të mbështesë përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në jetën social-ekonomike të komunitetit. Ky plan reflekton një angazhim të fortë për të përmbushur detyrimet e Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KDPK) dhe për të promovuar aksesueshmërinë, diversifikimin e shërbimeve dhe pjesëmarrjen aktive të këtyre qytetarëve në jetën publike dhe politike. Përmes këtij plani, Bashkia e Vlorës synon të krijojë një mjedis gjithëpërfshirës ku personat me aftësi të kufizuara mund të jetojnë me dinjitet dhe të realizojnë potencialin e tyre të plotë.

Hartimi i këtij plani është bazuar në një proces të detajuar dhe gjithëpërfshirës të vlerësimit të nevojave, duke përfshirë mbledhjen e të dhënave demografike dhe identifikimin e tipologjive të ndryshme të nevojave të personave me aftësi të kufizuara. Ky proces është realizuar në bashkëpunim të ngushtë me përfaqësues të personave me aftësi të kufizuara, organizata jofitimprurëse, si dhe institucione lokale dhe ndërkombëtare, për të siguruar që të gjitha zërat dhe perspektivat të përfshihen në mënyrë të plotë dhe të ndershme në hartimin e politikave.

Në përfundim, plani social për aftësinë e kufizuar 2025-2027 përbën një hap të rëndësishëm drejt përmirësimit të cilësisë së jetës së personave me aftësi të kufizuara në Vlorë. Objektivat e tij përfshijnë përmirësimin e aksesit në shërbime dhe infrastrukturë, zgjerimin e mundësive për pjesëmarrje në tregun e punës, dhe promovimin e një mjedisi që respekton dhe mbështet diversitetin. Realizimi i objektivave të tij kërkon një angazhim të vazhdueshëm dhe një qasje të integruar ndërsektoriale për të siguruar aksesueshmëri, shërbime të diversifikuara dhe pjesëmarrje të plotë dhe aktive të personave me aftësi të kufizuara në komunitet.

1. Identifikimi i tipologjisë së nevojave

1.1. Të dhënat demografike të personave me aftësi të kufizuara në Bashkinë Vlorë

Mbledhja e të dhënave për personat me aftësi të kufizuara në Bashkinë Vlorë është bazuar në informacionin e siguruar nga Drejtoria e Ndihmës Ekonomike dhe Shërbimeve Sociale, si dhe nga institucionet e tjera që veprojnë në varësi të bashkisë. Kohët e fundit, në Vlorë është implementuar modeli i ri i vlerësimit Bio-Psiko-Social, i cili realizohet nëpërmjet tre komisioneve multidisiplinare që operojnë për qarkun e Vlorës. Secili prej këtyre komisioneve përbëhet nga një mjek dhe një punonjës social, të cilët asistohet nga një operator për regjistrimin elektronik të të dhënave.

Kriteret bio-psiko-sociale të vlerësimit mundësojnë përcaktimin e saktë të shkallës së aftësisë së kufizuar në lidhje me kryerjen e veprimtarive bazë dhe instrumentale të jetës së përditshme (duke përfshirë edhe aftësinë për punë). Shkalla e dëmtimit klasifikohet në katër nivele të ndryshme:

- I lehtë (5-24%)
- I moderuar (25-49%)
- I rëndë (50-95%)
- I thellë ose i plotë (96-100%)

Ky model i vlerësimit lejon përcaktimin objektiv të nivelit të aftësisë së kufizuar, si dhe identifikimin e nevojave për shërbime shtesë, të tilla si: ndihmësi personal, paketat higjeno-sanitare, përkthyesi i gjuhës së shenjave, pajisjet ndihmëse për lëvizje, etj. Procesi i vlerësimit përfshin intervista të drejtpërdrejta, nëpërmjet të cilave komisioni formulon rekomandimet për përfitimet financiare dhe shërbimet e tjera shëndetësore, psiko-sociale, arsimore, të formimit profesional dhe punësimit. Bazuar në këtë informacion, krijohet një profil bio-psiko-social i individualizuar për përfituesit e aftësisë së kufizuar.

Të dhënat për personat me aftësi të kufizuara hidhen në një regjistër elektronik, të administruar nga zyra e vlerësimit të aftësisë së kufizuar pranë Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror. Ky regjistër duhet të jetë i integruar me shërbimet e tjera publike, duke përfshirë shërbimin shëndetësor, zyrën rajonale të shërbimit kombëtar të punësimit, drejtorinë arsimore rajonale dhe organizatat që ofrojnë shërbime për këtë grup. Kjo integrim synon të sigurojë që informacioni i detajuar i grumbulluar të përdoret për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve të ofruara në të gjitha nivelet e përfshirjes institucionale.

Aktualisht, Drejtoria e Ndihmës Ekonomike dhe Shërbimeve Sociale në Bashkinë Vlorë realizon pagesat në cash bazuar në vlerësimin bio-psiko-social, por ende nuk ka akses të plotë dhe mundësi për të shkarkuar të dhëna nga baza e të dhënave që gjeneron komisioni për çdo person me aftësi të kufizuar. Sigurimi i këtij akses do të ishte një hap i rëndësishëm drejt ndërhyrjeve të bazuara në

evidenca, duke përmbushur kështu një nga objektivat kryesore të këtij plani të vlefshëm. Gjithashtu, ky akses i plotë do të lejonte raportimin e detajuar të personave me aftësi të kufizuara, përfshirë diagnozën, shkallën e dëmtimit, nevojat për teknologji asistive, strukturën familjare dhe nevojat për shërbime specifike.

Një panoramë më e plotë e situatës së aftësisë së kufizuar mund të sigurohet përmes zbatimit të Ligjit Nr. 93/2014, neni 17, i cili përcakton detyrimin e institucioneve për të mbledhur dhe raportuar të dhëna statistikore për aftësinë e kufizuar sipas fushave ku ato operojnë, siç përcaktohet në VKM nr. 708, datë 26.8.2015, “Për llojet, periodicitetin dhe mënyrën e raportimit të të dhënave statistikore për aftësinë e kufizuar nga strukturat shtetërore përgjegjëse, në nivel qendror dhe vendor”. Në këtë drejtim, kërkohet një koordinim dhe përpjekje sistematike ndërmjet institucioneve përkatëse. Gjithashtu, Instituti i Statistikave të Shqipërisë (INSTAT) ka filluar përfshirjen e disa moduleve pyetjesh mbi aftësinë e kufizuar në studimet kombëtare, siç janë Censusi 2021, Anketa e të Ardhurave dhe Jetës (SILC), dhe Anketa e Shëndetësisë (EHIS) 2020.

Sigurimi i të dhënave të sakta dhe të përditësuara për personat me aftësi të kufizuara është thelbësor për hartimin e politikave efektive dhe për ofrimin e shërbimeve të përshtatura për nevojat e tyre. Planin social për aftësinë e kufizuar në Bashkinë Vlorë synon të sigurojë një qasje gjithëpërfshirëse dhe të integruar, duke bashkëpunuar ngushtë me të gjitha institucionet dhe organizatat përkatëse. Kjo qasje do të mundësojë përmirësimin e cilësisë së jetës për personat me aftësi të kufizuara dhe garantimin e të drejtave të tyre, në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare.

1.1.1 Numri i personave me aftësi të kufizuara në Bashkinë Vlorë sipas gjinisë, strukturës moshore me referencë fëmijë dhe të rritur, njësisë administrative dhe llojeve të aftësisë së kufizuar.

Sipas të dhënave të mbledhura nga Bashkia Vlorë dhe të paraqitura në tabelën 1, rezultojnë gjithsej 2,408 persona me aftësi të kufizuara. Nga këta, 1,569 persona kanë aftësi të kufizuara fizike dhe mendore, 532 persona kanë probleme me shikimin, 280 janë para-tetraplegjikë. Krahas tyre në bashkinë Vlorë janë edhe dhe 2,692 invalidë pune. Rreth 29% e personave me aftësi të kufizuara (697 persona) kanë diagnoza të rënda dhe mbështeten nga një kujdestar që përfiton pagesën e kujdestarisë në kuadër të skemës së mbrojtjes sociale.

Në aspektin gjeografik, 67% e personave me aftësi të kufizuara jetojnë në qytetin e Bashkisë Vlorë, që përfshin 1,131 persona, ndërsa pjesa tjetër është e shpërndarë në njësitë administrative pa dallime të mëdha mes tyre. Kjo shpërndarje lidhet ngushtë me numrin më të madh të banorëve në zonën urbane të Bashkisë Vlorë, krahasuar me njësitë e tjera administrative.

Nga të dhënat e Drejtorisë së Ndihmës Ekonomike dhe Shërbimeve Sociale të Bashkisë Vlorë rezulton se ka 207 fëmijë me aftësi të kufizuara¹. Sipas kategorive të aftësisë së kufizuar, numri më i madh i fëmijëve përbëhet nga ata me çrregullime të spektrit të autizmit, gjithsej 90 fëmijë. Kjo ndiqet nga fëmijët me sëmundje kronike (48 fëmijë), fëmijët me çrregullime të shëndetit mendor dhe emocionale (34 fëmijë), dhe fëmijët me aftësi të kufizuara fizike (19 fëmijë). Kategoritë e tjera të aftësisë së kufizuar përbëjnë një numër më të vogël të fëmijëve. Për shkak të shpërndarjes së popullsisë, përqindja më e madhe e fëmijëve me aftësi të kufizuara është nga qyteti i Vlorës dhe

1. Këtu mungojnë të dhënat nga njësia administrative Shushicë

zona qendrore e saj, por fëmijët nga njësitë e tjera administrative gjithashtu përballen me sfida dhe barrierë të ndryshme.

Për sa i përket të rriturve me aftësi të kufizuara, për vitin 2023 numri total arrin në 2,383 persona. Brenda kësaj grupmoshe, numri më i madh është i të rriturve me aftësi të kufizuara në shikim (persona të verbër), me një total prej 520 personash, shumica e të cilëve raportohen në qytetin e Vlorës. Të rriturit me aftësi të kufizuara fizike (para-tetraplegjikë) përbëjnë një tjetër kategori të madhe, me një total prej 268 personash. Të rriturit me aftësi të kufizuara mendore ose çrregullime emocionale të sjelljes përbëjnë 482 persona, ndërsa të rriturit me aftësi të kufizuara fizike dhe intelektuale të kombinuara arrijnë në 89 persona. Kategoritë e tjera përfshijnë të rriturit me sëmundje kronike (256 persona) dhe ata me çrregullime të spektrit të autizmit (28 persona).

Në përgjithësi, Bashkia Vlorë është njësia administrative me numrin më të madh të personave me aftësi të kufizuara, duke reflektuar një nevojë të lartë për shërbime mbështetëse dhe burime në këtë zonë. Këto të dhëna tregojnë për një nevojë urgjente për rritjen e mbështetjes dhe përmirësimin e shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara, jo vetëm në qytetin e Vlorës, por edhe në njësitë e tjera administrative, me qëllim sigurimin e një përfshirjeje të plotë dhe përmirësimin e cilësisë së jetës për të gjithë individët me aftësi të kufizuara.

Tabela 1: Personat me aftësi të kufizuara sipas njësive administrative

EMËRTIMI	PAK		TE VERBËR		PARA- TETRAPLEGJIK		PAK MENDOR FIZIK	
	Gjithsej	Me përfitim kujdestari	Gjithsej	Me përfitim kujdestari	Gjithsej	Me Përfitim Kujdestari	Gjithsej	Me përfitim kujdestari
TOTALI BASHKIA	2408	697	532	129	280	280	1596	288
Vlorë	1761	530	408	97	222	222	1131	211
Qendër	195	56	51	15	15	15	129	26
Orikum	132	33	21	5	12	12	99	16
Novoselë	199	44	35	8	16	16	148	20
Shushicë	121	34	17	4	15	15	89	15

Në Bashkinë Vlorë, numri total i invalidëve të punës është 2,692 persona, të shpërndarë si më poshtë:

- Njësia Administrative Vlorë Qendër: 309 persona
- Njësia Administrative Orikum: 214 persona
- Njësia Administrative Novoselë: 92 persona
- Njësia Administrative Shushicë: 105 persona
- Qyteti i Vlorës: 1,972 persona

Sipas klasifikimit të grupeve të aftësisë së kufizuar, invalidët e punës përbëjnë grupin më të madh, me një total prej 2,692 personash. Shumica e tyre, konkretisht 1,972 persona, janë të përqendruar në qytetin e Vlorës, ndërsa njësia administrative me numrin më të vogël të invalidëve të punës është Novosela, me 92 persona.

Këto të dhëna tregojnë për një përqendrim të konsiderueshëm të invalidëve të punës në qytetin e Vlorës, gjë që nënvizon nevojën për shërbime dhe mbështetje të specializuara në këtë zonë,

krahasuar me njësitë e tjera administrative. Përmirësimi i infrastrukturës mbështetëse dhe ofrimi i shërbimeve të përshtatura për këtë grup janë të domosdoshme për të siguruar një cilësi më të mirë të jetës për invalidët e punës në të gjithë Bashkinë Vlorë.

1.1.2 Numri i personave me aftësi të kufizuara që janë të punësuar.

Ligji “Për Nxitjen e Punësimit” ka për qëllim të promovojë përfshirjen e qytetarëve në tregun e punës, me një fokus të veçantë tek grupet vulnerabël, përfshirë personat me aftësi të kufizuara. Ky ligj përmban dispozita kyçe që përcaktojnë detyrimet e punëdhënësve për të punësuar persona me aftësi të kufizuara, si dhe ofron mekanizma mbështetës për këta individë. Sipas ligjit, çdo punëdhënës është i detyruar të punësojë një person me aftësi të kufizuara për çdo 25 punonjës; për çdo 50 punonjës shtesë, punëdhënësi duhet të punësojë një person tjetër me aftësi të kufizuara. Në rast mosrespektimi të këtyre detyrimeve, ligji parashikon masa ndëshkuese për punëdhënësit. Gjithashtu, ligji ofron mekanizma mbështetës, të tillë si subvencione dhe stimuj financiarë për punëdhënësit që punësojnë persona me aftësi të kufizuara; programe trajnimi dhe formimi profesional për të përgatitur këta persona për tregun e punës; dhe shërbime ndërmjetësimi dhe këshillimi në punësim për personat me aftësi të kufizuara.

Rezultatet në lidhje me punësimin e personave me aftësi të kufizuara janë larg pritshmërive. Në fokus grupi me aktorët u identifikua se numri i personave me aftësi të kufizuara të punësuar është tejtejt i ulët, duke arritur deri në vetëm 16 persona, shumica e të cilëve janë punësuar në sektorin privat, dhe vetëm dy prej tyre në institucionin e Bashkisë Vlorë.

Pavarësisht përmirësimeve në legjislacion, shumë persona me aftësi të kufizuara ende përballen me sfida të mëdha në hyrjen dhe qëndrimin në tregun e punës. Disa nga këto sfida përfshijnë mungesën e infrastrukturës së përshtatshme dhe të ambienteve të punës që të jenë të aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara; stigmatizimin dhe diskriminimin ndaj këtyre personave në vendin e punës; si dhe mungesën e programeve efektive të trajnimit dhe mbështetjes për punëdhënësit dhe punëmarrësit.

Për të përmirësuar situatën, Shërbimi Rajonal i Punësimit dhe Bashkia Vlorë mund të dakordësojnë për raportim periodik dhe pasurim të bazës së të dhënave për personat me aftësi të kufizuara. Kjo përfshin mbledhjen e të dhënave të sakta dhe të përditësuara mbi numrin e personave të punësuar, shkallën e dëmtimit, nevojat për teknologji asistive dhe shërbime specifike. Përmirësimi i koordinimit dhe bashkëpunimit ndërmjet institucioneve shtetërore dhe organizatave joqeveritare është thelbësor për të siguruar respektimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara dhe për të rritur përfshirjen e tyre në tregun e punës.

Ligji “Për Nxitjen e Punësimit” përmban dispozita të rëndësishme për përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në tregun e punës. Megjithatë, për të arritur qëllimet e tij, është e nevojshme një qasje më e fortë në zbatimin dhe monitorimin e ligjit, si dhe mbështetje e shtuar për punëdhënësit dhe personat me aftësi të kufizuara. Vetëm përmes këtyre përpjekjeve të koordinuara mund të sigurohet një treg pune më gjithëpërfshirës dhe të përmirësohet cilësia e jetës për personat me aftësi të kufizuara në Shqipëri.

1.1.3 Shërbimet shëndetësore në Bashkinë Vlorë për personat me aftësi të kufizuara

Në bashkinë e Vlorës shërbimet shëndetësore ofrohen nëpërmjet shërbimit parësor dhe spitalor.

Spitali Rajonal i Vlorës është qendra kryesore e kujdesit shëndetësor dhe ofron shërbime të specializuara, të cilat përfshijnë:

- Kujdesi emergjent, nëpërmjet shërbimit të urgjencës 24/7 për të gjitha llojet e emergjencave mjekësore.
- Shërbimet kirurgjikale, përkatësisht kirurgjia e përgjithshme, ortopedia, neurokirurgjia, dhe të tjera.
- Shërbimet mjekësore si kardiologjia, neurologjia, onkologjia, endokrinologjia, etj.
- Shërbimet diagnostikuese, laboratorë mjekësorë, imazheria, radiologjia, etj.
- Kujdesi intensive për pacientët në gjendje kritike.

Përveç shërbimeve spitalore, shërbimet shëndetësore janë të disponueshme edhe në qendrat shëndetësore:

- Qendra Shëndetësore Nr. 1 (Qyteti i Vlorës): Ofron kujdes parësor, përfshirë vizitat mjekësore, vaksinimet, shërbimet pediatrike dhe gjinekologjike, si dhe këshillimin për planifikimin familjar dhe sëmundjet kronike.
- Qendra Shëndetësore Nr. 2 (Qyteti i Vlorës): Ofron kujdes parësor dhe të specializuar, duke përfshirë mjekët e përgjithshëm dhe specialistët, si dhe shërbime për kujdesin e nënës dhe fëmijës dhe kujdesin për të moshuarit.
- Qendra Shëndetësore Orikum: Siguron shërbime mjekësore për banorët e Orikut dhe zonave përreth, përfshirë kujdesin parësor, kontrollet shëndetësore, vaksinimet dhe këshillimin.
- Qendra Shëndetësore Novoselë: Ofron kujdes parësor për komunitetin lokal, përfshirë shërbimet e mjekësisë së përgjithshme, kujdesin për nënën dhe fëmijën dhe menaxhimin e sëmundjeve kronike.
- Qendra Shëndetësore Shushicë: Ofron shërbime parësore për banorët e Shushicës dhe zonave të afërta, përfshirë vizitat mjekësore, shërbimet pediatrike dhe gjinekologjike, si dhe këshillimin për sëmundjet kronike.

Qendrat shëndetësore ofrojnë gjithashtu një sërë programesh dhe shërbimesh të tjera:

- Programet e Vaksinimit: Sigurimi i imunizimit të fëmijëve dhe të rriturve sipas kalendarit kombëtar të vaksinimit.
- Shërbimet e Shëndetit Mendor: Këshillimi dhe trajtimi për çrregullimet e shëndetit mendor, ofruar në qendrat shëndetësore dhe spitalin rajonal.
- Programet për Parandalimin dhe Kontrollin e Sëmundjeve Kronike: Trajtimi dhe menaxhimi i diabetit, hipertensionit dhe sëmundjeve kardiovaskulare.
- Shërbimet për Shëndetin e Nënës dhe Fëmijës: Kujdes para dhe pas lindjes, këshillim për ushqyerjen e foshnjave dhe planifikimin familjar.

Koordinimi i shërbimeve dhe fokusimi në aftësinë e kufizuar

Bashkia e Vlorës dhe institucionet shëndetësore parashikohet të bashkëpunojnë ngushtë për të siguruar një ofrim të koordinuar dhe efektiv të shërbimeve shëndetësore, duke përfshirë ndërlidhjen

midis shërbimeve shëndetësore dhe sociale. Ky bashkëpunim synon të adresojë nevojat specifike të personave me aftësi të kufizuara dhe grupeve të tjera vulnerabël, duke përfshirë raportimin periodik të të dhënave shëndetësore për të siguruar monitorimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimeve.

Qendrat shëndetësore në Bashkinë e Vlorës janë të integruara në strukturën e Drejtorisë Rajonale të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor (QSHKSH) të rajonit përkatës. Kujdesi shëndetësor parësor ofrohet për popullatën nga njësitë bazë të shërbimit, si qendrat shëndetësore kryesore në qytet dhe qendrat e njësive administrative, si dhe nga ambulancat ose pikat shëndetësore në nivel fshati.

Kujdesi shëndetësor për fëmijët dhe ndërhyrja e hershme

Në kujdesin shëndetësor për fëmijët, qendrat shëndetësore kanë për qëllim të sigurojnë identifikimin e hershëm të fëmijëve me nevoja të veçanta dhe t'i referojnë ata tek specialistët e duhur. Personeli shëndetësor është i angazhuar në monitorimin e rritjes dhe zhvillimit të fëmijës, kryerjen e testeve depistuese për problemet e zhvillimit, dëgjimit dhe shikimit, dhe matjet antropometrike sipas udhëzimeve të ndjekjes së mirërritjes dhe zhvillimit të fëmijëve.

Sipas paketës për shërbimin parësor, mjekët dhe infermierët/mamive të qendrave shëndetësore organizojnë vizita në familje për fëmijët me nevoja të veçanta, bazuar në vlerësimin individual të bërë nga personeli mjekësor. Në rastet kur është e nevojshme, fëmijët referohen tek:

- Neuropediatri
- Qendra Kombëtare për Mirërritjen, Zhvillimin dhe Rehabilitimin e Fëmijës
- Specialistët ORL
- Poliklinikat e specialiteteve pediatrike
- Punonjësit socialë për çështje zhvillimore, konjitive dhe sociale

Qendrat shëndetësore kanë përgjegjësinë për ndërhyrjen e hershme në rastet e aftësisë së kufizuar, duke synuar parandalimin, lehtësimin dhe menaxhimin në kohë dhe me cilësi të lartë të nevojave të fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Bashkëpunimi ndërsektorial dhe menaxhimi i rasteve

Qendrat shëndetësore në Bashkinë Vlorë parashikohet të luajnë një rol kyç në ofrimin e kujdesit shëndetësor për fëmijët dhe komunitetin në përgjithësi. Ato duhet të bashkëpunojnë ngushtë me Bashkinë Vlorë për menaxhimin e rasteve të fëmijëve që kanë nevojë për shërbime shëndetësore, përfshirë fëmijët me aftësi të kufizuara. Ky bashkëpunim ndihmon në identifikimin dhe ndërhyrjen e hershme, vlerësimin dhe adresimin në kohë, si dhe sigurimin e një shërbimi ndërdisiplinar dhe gjithëpërfshirës.

Mjeku i familjes ose i konsultores në qendrat shëndetësore, sipas sistemit të referimit, kur e vlerëson të nevojshme, e referon pacientin tek qendrat e specialiteteve ose në shërbimin spitalor, në varësi të situatës së pacientit. Pas trajtimit ose ndërhyrjes, qendrat e specialiteteve ose shërbimi spitalor, kur është e nevojshme, e rikthejnë pacientin tek mjeku i familjes për ndjekje të mëtejshme, përfshirë edhe rekomandimet për trajtim të mëtejshëm dhe receta të rimbursueshme. Në këtë skemë, shërbimi parësor mbetet porta kryesore dhe monitoruese për qytetarët.

Përmirësimi i shërbimeve dhe nevojat për përmirësim

Nga takimet me personat me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre janë identifikuar disa nevoja për përmirësime në shërbimet parësore dhe spitalore, duke përfshirë shërbimet në banesë, problemet e aksesueshmërisë (rampat sipas standarteve, tualetet e përshtatshme, ashensorët etj) dhe cilësinë e shërbimit në varësi të nevojave specifike të fëmijëve dhe të rriturve me aftësi të kufizuara. Këto nevoja tregojnë për domosdoshmërinë e përmirësimit të infrastrukturës, rritjen e aksesit dhe cilësisë së shërbimeve shëndetësore për të siguruar një qasje gjithëpërfshirëse dhe të orientuar drejt individit.

1.1.4 Sistemi i Edukimit dhe Kujdesit për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara në Bashkinë Vlorë

Bashkia e Vlorës disponon një rrjet institucionesh të kujdesit dhe edukimit, që përfshin çerdhe, kopshte dhe shkolla. Këto institucione ofrojnë shërbime për fëmijët e moshave të ndryshme, duke filluar nga fëmijëria e hershme deri në arsimin parauniversitar. Qëllimi kryesor i këtyre institucioneve është të ofrojnë një edukim cilësor dhe të aksesueshëm për të gjithë fëmijët, pavarësisht prejardhjes sociale apo ekonomike.

Në Bashkinë e Vlorës operojnë 3 çerdhe publike që ofrojnë kujdes dhe edukim për 74 fëmijë të moshave 6 muaj deri në 3 vjeç. Aktualisht, ekziston një mungesë e punonjësve socialë dhe psikologëve, të cilët luajnë një rol kritik në vlerësimin dhe ndërhyrjen e hershme për fëmijët dhe familjet e tyre, si dhe në koordinimin e punës me stafin. Këto institucione duhet të sigurojnë një mjedis të sigurt dhe të kujdesshëm ku fëmijët mund të zhvillojnë aftësitë e tyre fizike, intelektuale dhe sociale. Shërbimet kryesore të ofruara nga çerdhet përfshijnë:

- Kujdesi bazë ditor, si ushqimi, gjumi dhe aktivitetet e lojërave.
- Aktivitetet educative përfshirë nxitjen e zhvillimit të hershëm të fëmijëve.
- Mbështetje për fëmijët me nevoja të veçanta, duke përfshirë bashkëpunimin me specialistët përkatës për ndërhyrje dhe mbështetje adekuate.

Bashkia e Vlorës ka gjithsej 42 kopshte publike, prej të cilave 8 ofrojnë shërbimin e drekës dhe 34 pa shërbimin e drekës. Këto kopshte ofrojnë edukim për fëmijët nga mosha 3 deri në 6 vjeç, duke i përgatitur ata për hyrjen në shkollën fillore. Aktualisht janë të regjistruar 2091 fëmijë, nga të cilët 44 janë me aftësi të kufizuara. Mungesa e punonjësve socialë dhe psikologëve në kopshte paraqet një sfidë të rëndësishme, duke ndikuar në mbështetjen dhe shërbimet për fëmijët me aftësi të kufizuara. Kopshtet janë të pajisura me infrastrukturë dhe personel të kualifikuar për të siguruar një ambient edukativ të pasur dhe të sigurt. Shërbimet kryesore përfshijnë:

- Edukimi parashkollor, zhvillimi kognitiv, emocional dhe social i fëmijëve.
- Aktivitetet krijuese dhe lojërat, nxitja e zhvillimit të aftësive motorike dhe sociale.
- Kujdesi për shëndetin dhe higjienën përfshirë shërbimet shëndetësore bazë dhe këshillimi për prindërit.

Në Bashkinë e Vlorës funksionojnë gjithsej 64 shkolla, të ndara në dy nivele kryesore: 49 shkolla 9-vjeçare që ofrojnë arsimin bazë për fëmijët nga klasat 1 deri në 9-të, dhe 15 shkolla të mesme. Numri total i nxënësve në shkollat 9-vjeçare është 7697, nga të cilët 114 janë me aftësi të kufizuara (98 me aftësi të kufizuara mendore dhe 14 me aftësi të kufizuara fizike). Numri i mësuesve ndihmës në këto shkolla është 95. Në shkollat e mesme janë regjistruar 2128 nxënës, nga të cilët 21 janë me

aftësi të kufizuara (10 me aftësi të kufizuara mendore dhe 11 me aftësi të kufizuara fizike), me një total prej 7 mësuesish ndihmës. Vlen të thekshet se në Vlorë ka një shkollë speciale cila është e vetjma që përmbush një pjesë të konsiderueshme të standarteve të aksesueshmërisë.

Në total, 135 fëmijë me aftësi të kufizuara ndjekin shkollat në Vlorë, prej të cilëve 108 me aftësi të kufizuara mendore dhe 27 me aftësi të kufizuara fizike.

Aksesueshmëria dhe infrastruktura mbështetëse. Aktualisht, raportohet se 28 shkolla nga 64 janë të pajisura me rampa për lehtësimin e hyrjes së nxënësve me aftësi të kufizuara. Megjithatë, asnjëra prej tyre nuk ka rampa me doreza mbajtëse, duke treguar një nevojë për përmirësim të infrastrukturës mbështetëse që siguron lëvizje të sigurt.

Sa i përket tualeteve dhe ashensorëve, vetëm një shkollë është e pajisur me tualete të përshtatura për fëmijët që përdorin karrocë, një shifër që tregon nevojën për investime të mëtejshme. Nuk ka shkolla të pajisura me ashensorë, gjë që kufizon aksesin në katet më të larta për nxënësit me aftësi të kufizuara. Vetëm një shkollë ka një ashensor të pajisur me sinjale zanore dhe shkronja Braille, duke e bërë këtë veçori shumë të rrallë dhe të domosdoshme për nxënësit me dëmtime të shikimit.

Shkollat kanë gjithsej 102 mësues ndihmës, duke treguar një përpjekje për të siguruar mbështetje të dedikuar për nxënësit me nevoja të veçanta. Megjithatë, ekziston një mungesë e mësuesve të specializuar në disa shkolla, gjë që tregon nevojën për rritjen e kapaciteteve të stafit mbështetës.

Problematikat e identifikuara gjatë intervistave dhe fokusgrupeve lidhen kryesisht me infrastrukturën e përshtatshme, mungesën e mjeteve didaktike dhe vështirësitë e transportit. Një nga problemet kryesore të raportuara është mungesa e mjeteve të transportit të përshtatura për fëmijët me aftësi të kufizuara, gjë që ndikon negativisht në frekuentimin e rregullt të shkollës. Përgatitja dhe sigurimi i mjeteve didaktike duhet të vlerësohet rast pas rasti nga komisionet e shkollave dhe të përfshihet në Planin e Edukimit Individual (PEI). Gjithashtu, prindërit raportojnë mungesën e mjediseve të përshtatshme dhe mjeteve ndihmëse, si bankat e përshtatshme për fëmijët që përdorin karroca dhe hapësira të mjaftueshme brenda klasave.

Bazuar më sipër disa nga çështjet kryesore të rëndësishme për tu adresuar paraqiten:

- zgjerimi i infrastrukturës së aksesueshmërisë si përfshirja e rampave me doreza mbajtëse dhe tualeteve të përshtatshme;
- instalimi i ashensorëve me teknologji ndihmëse konkretisht pajisja e shkollave me ashensorë që përmbajnë sinjale zanore dhe shkronja Braille për nxënësit me dëmtime të shikimit dhe lëvizjes;
- tritja e kapaciteteve të stafit mbështetës, si trajnime të vazhdueshme për mësuesit ndihmës dhe stafin për përmirësimin e shërbimeve dhe mbështetjes për nxënësit me nevoja të veçanta;
- përmirësimi i infrastrukturës dhe pajisjeve mësimore të përshtatura për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe bashkëpunimi i ngushtë ndërmjet institucioneve arsimore, bashkisë dhe komunitetit për të siguruar mbështetje të plotë për nxënësit me aftësi të kufizuara.

Për të arritur një mjedis mësimor më gjithëpërfshirës dhe të drejtë për të gjithë nxënësit, është e nevojshme të merren masa konkrete për përmirësimin e infrastrukturës, rritjen e kapaciteteve të stafit dhe sigurimin e burimeve të nevojshme. Angazhimi i vazhdueshëm dhe bashkëpunimi ndërmjet të gjitha palëve të interesuara do të sigurojë një cilësi më të mirë të jetës dhe edukimit për fëmijët me aftësi të kufizuara në Vlorë.

1.1.5 Buxheti njësisë vendore për aftësinë e kufizuar; Shpenzimet e kujdesit shoqëror (si përqindje e buxhetit vendor) dhe raportin që zë në këtë buxhet shpenzimet për shërbimet për personat me aftësi të kufizuara.

Tabela që i referohet shpenzimeve për aftësinë e kufizuar në Bashkinë Vlorë ofron një pamje të qartë të ndryshimeve në numrin e përfituesve dhe fondin e përdorur për disa kategori specifike gjatë viteve 2022 dhe 2023. Në kategorinë e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe kujdestarëve, numri i përfituesve ka pësuar një rënie të vogël nga viti 2022 në vitin 2023, nga 1,987 në 1,970 përfitues. Kjo rënie shoqërohet me një ulje të lehtë të fondeve të përdorura, nga 261,592,000 lekë në 257,876,000 lekë. Kategoria e Tetraplegjikëve dhe kujdestarëve, në ndryshim nga kategoria e mëparshme, tregon një rritje të lehtë në numrin e përfituesve nga 560 në 568, e cila shoqërohet me një rritje të fondeve të shpërndara nga 143,124,000 lekë në 147,615,000 lekë. Kjo ndër të tjera mund të tregoj një prioritet të shtuar ose një nevojë të rritur për këtë kategori specifike.

Në rastin e personave me problem në shikim dhe kujdestarëve të tyre, ndonëse ka një ulje të lehtë në numrin e përfituesve nga 663 në 644, fondet e alokuara kanë pësuar një rritje, duke kaluar nga 114,699,000 lekë në 121,780,000 lekë. Në kategorinë e invalidëve, ka një rënie të lehtë si në numrin e përfituesve, nga 2,417 në 2,401, ashtu edhe në fondet përkatëse, të cilat kanë zbritur nga 93,852,000 lekë në 91,839,000 lekë.

Në total, të dhënat e ofruara tregojnë se ka pasur një rënie të lehtë në numrin e përgjithshëm të përfituesve, nga 5,627 në 5,583, dhe një rritje të lehtë në fondet e shpërndara. Shpenzimet totale për vitin 2022 janë 643,958,000 lekë, ndërsa për vitin 2023 ato janë rritur në 649,228,000 lekë. Në rastin e V.K.M-159, ka një rritje të dukshme të fondeve nga 13,590,000 lekë në 17,283,000 lekë, duke reflektuar ndoshta një ndryshim në politikën e subvencionimit ose një rritje të numrit të përfituesve të kualifikuar për këtë kategori. Shpërblimet e fundvitit për vitet 2022 dhe 2023 gjithashtu tregojnë një rritje të dukshme në fondet e shpërndara, nga 4,653,000 lekë në 12,835,000 lekë, duke pasqyruar një vendim politik për të ofruar një mbështetje më të madhe financiare gjatë këtyre viteve. Për më tepër, fondi i alokuar për zbutjen e krizave në vitin 2022 ka qenë 12,448,000 lekë, një kategori që nuk duket të ketë të dhëna për vitin 2023, duke sugjeruar një ndryshim të mundshëm në politikat ose në nevojat e identifikuar nga Bashkia Vlorë për atë vit.

Në përfundim, të dhënat tregojnë një ndryshim të vogël në numrin e përfituesve dhe një rritje të moderuar në fondet totale të shpërndara nga viti 2022 në vitin 2023. Kjo mund të reflektojë optimizim të resurseve, ndryshime në politikat e shpërndarjes ose nevoja të ndryshme të identifikuar në lidhje me mbështetjen për personat me aftësi të kufizuara.

Tabela 2. Numri i përfituesve dhe fondi i përdorur për personat me aftësi të kufizuara

Emërtimi	P.A.K + kujdestarë		Tetraplegjik+ kujdestarë		Verbëri kujdestari		Invalid		Total	
	Nr.	000/Lek	Nr.	000/Lek	Nr.	000/Lek	Nr.	000/Lek	Nr.	000/Lek
P.A.K 22	1987	261.592	560	143.124	663	114.699	2417	93.852	5627	613.267
P.A.K 23	1970	257.876	568	147.615	644	121.780	2401	91.839	5583	616.495
V.K.M-159	1501	13.590	161	1.467	244	2.226	-	-	1.906	17.283
Shperblim fundvit 22	1551	4.653	264	792	526	1578	-	-	2.341	7.023
Shperblim fundvit 23	1496	8.525	288	1.620	538	2.690			2.322	12.835
Zbutje krize 22	1556	12.448	273	2.184	532	4.256	-	-	2361	18.888
TOTALI V.2022		292.283		147.567		122.759		93.852		656.461
TOTALI V.2023		266.404		149.235		124.470		91.839		629.425

*Burimi. Bashkia Vlorë

Ndërsa buxheti i bashkisë për shërbimet për personat me aftësi të kufizuara realizohet nëpërmjet qendrës komunitare bashkiake e cila ka një ekip të dedikuar për aftësinë e kufizuar.

Tabela 3. Numri i përfituesve dhe fondi i përdorur për personat me aftësi të kufizuara

Periudha	Pagesat për personat me aftësi të kufizuara		
2022	PAK fondi i celur +	nr. individ	Fond TOTAL
Janar		5622	50 189 756
Shkurt		5611	50 503 821
Mars		5572	49 415 899
Prill		5577	49 914 549
Maj		5583	50 680 609
Qershor		5591	51 746 590
Korrik		5598	49 462 067
Gusht		5592	48 010 739
Shtator		5586	49 684 955
Tetor		5619	54 421 598
Nëntor		5526	52 611 973
Dhjetor		5429	54 640 351
Totali			655 942 871 (ne vlere perفشihet edhe shperblimi i fundvitit)

*Burimi. Bashkia Vlorë

1.2 Profili dhe karakteristikat e përdoruesve të shërbimit

1.2.1 Burimet njerëzore dhe shërbimet për personat me aftësi të kufizuara;

Për hartimin dhe zbatimin e Planit Lokal Social për Personat me Aftësi të Kufizuara në Bashkinë Vlorë, Drejtoria e Ndihmës dhe Shërbimit Social luan një rol kyç në procesin e përgjithshëm. Kjo drejtori mbulon pesë rajone të qytetit dhe katër njësi administrative: Qendër, Orikum, Novoselë, dhe Shushicë. Gjithashtu, drejtoria përfshin disa njësi të specializuara që mbulojnë fusha të ndryshme të mbrojtjes sociale, si Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve, Njësia e Dhunës në Familje, Njësia e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit të Rasteve, Sektori i Barazisë Gjinore, dhe Shërbimi Mbështetës për Fëmijët dhe Familjet. Po ashtu, përfshihet Sektori i Trajtimit të Personave me Aftësi të Kufizuara dhe Specialistët e Sektorit të Financë-Statistikës.

Gjatë vitit 2023, Drejtoria e Ndihmës dhe Shërbimit Social ka përballuar sfida të vazhdueshme, por gjithashtu ka demonstruar shembuj pozitivë të bashkëpunimit brenda rrjetit të konsoliduar të shërbimeve sociale në Bashkinë Vlorë. Ky rrjet përfshin bashkëpunimin kompleks me institucionet shtetërore dhe organizatat joqeveritare që veprojnë në nivel lokal dhe kombëtar. Në strukturën e Drejtorisë së Ndihmës dhe Shërbimit Social janë bërë përmirësime të rëndësishme. Në vitin 2022, u shtua pozicioni i Nëpunësit të Barazisë Gjinore në Sektorin e Çështjeve të Barazisë Gjinore, dhe në vitin 2023, pozicioni i Specialistit të Njesisë së Vlerësimit dhe Referimit të Nevojave. Këto ndryshime strukturore reflektojnë përkushtimin e drejtorisë për të përmirësuar cilësinë dhe larmishmërinë e shërbimeve të ofruara për qytetarët.

Qendra e Shërbimeve Komunitare për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara

Qendra e Shërbimeve Komunitare për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara ofron shërbime prej disa vitesh me një staf të specializuar që përfshin psikologë (2), punonjës social (1), fizioterapistë (4), logopedë (2), edukatorë specialë (2), dhe drejtuesin e qendrës. Sipas të dhënave të raportuara, kjo qendër ofron shërbime për 65 fëmijë me aftësi të kufizuara, të cilët marrin mbështetje të ndryshme për zhvillimin e tyre dhe për përmirësimin e cilësisë së jetës. Shërbimet e ofruara përfshijnë:

- Terapia intensive psikosociale për aftësim mendor dhe rehabilitim social.
- Terapia psikomotore për zhvillimin e aftësive motorike.
- Aftësimi i parametrave fizikë për përmirësimin e aftësive fizike.
- Shërbimet ortofonike për përmirësimin e aftësive të folurit dhe të gjuhës.
- Terapia e zhvillimit për fëmijët me nevoja të ndryshme rehabilituese.

Në Qendrën e Zhvillimit, terapia intensive psikosociale për aftësim mendor dhe rehabilitim social ka qenë një nga shërbimet më të përdorura, me një total prej 55 seancash të mbajtura. Ky shërbim ka përfshirë një gamë të gjerë përfituesish, përfshirë fëmijë me aftësi të kufizuara fizike dhe intelektuale, çrregullime të spektrit të autizmit dhe sëmundje kronike. Terapia psikomotore, një tjetër shërbim kyç për zhvillimin e aftësive motorike të fëmijëve, ka përfshirë 17 seanca, ndërsa aftësimi i parametrave fizikë ka përfshirë 14 seanca, të fokusuara në përmirësimin e aftësive fizike të fëmijëve. Shërbimi ortofonik ka qenë më i kufizuar, me vetëm 2 seanca të mbajtura.

Gjatë fokus grupit me prindërit e fëmijëve, shërbimet e ofruara dhe angazhimi i stafit janë vlerësuar pozitivisht, por janë identifikuar disa çështje të rëndësishme për përmirësim. Një nga shqetësimet

kryesore lidhet me pamjaftueshmërinë e shërbimeve të logopedisë dhe frekuencës së seancave, të cilat duhet të jenë të bazuara në nevojat specifike të fëmijëve. Ky kufizim vjen si rezultat i numrit të madh të fëmijëve, stafit të pamjaftueshëm, dhe hapësirave të kufizuara që pengojnë ofrimin e shërbimeve më intensive për çdo fëmijë. Një tjetër çështje mbetet transporti për në qendër, pavarësisht se shpenzimet e transportit mbulohen nga bashkia, mungesa e aksesit në transportin publik e bën të vështirë arritjen në qendër dhe përfitimin nga shërbimet.

Prindërit kanë shprehur gjithashtu shqetësime në lidhje me mungesën e shërbimeve të tjera alternative, veçanërisht për adoleshentët dhe të rriturit, kufizimet e mjeteve didaktike për grupmoshat specifike, si dhe sfidat dhe barrierat burokratike, përfshirë mungesën e informacionit në lidhje me nevojat e tyre të herëpashershme, qofshin ato administrative, ligjore, apo të tjera. Një tjetër çështje urgjente e raportuar nga prindërit është nevoja për sesione informuese dhe trajnime për prindërit, si dhe seancat e supervizimit me psikologët.

Stafi i qendrës së shërbimeve komunitare shpesh angazhohet jo vetëm për ofrimin e shërbimeve për fëmijët në qendër, por edhe për të ofruar ekspertizë në institucione dhe shërbime të tjera, si ato arsimore për arsye të përvojës dhe njohuritë e tyre të specializuara. Kjo situatë shpesh krijon një ngarkesë të shtuar dhe një nevojë për të rritur kapacitetin e përfituesve dhe të shërbimeve të ofruara, çka mund të ndikojë në cilësinë dhe sasinë e shërbimeve të ofruara.

Bashkia Vlorë, përmes qendrës komunitare, po ofron një gamë shërbimesh për fëmijët me aftësi të kufizuara, por vlen të theksohet se shërbimet për të rriturit janë të munguara dhe paraqitet emergjente ofrimi i tyre. Nga fokus grupi me aktorët rezulton se bashkia e Vlorës është në process të hartimit të planit lokal social dhe ndër të tjera është duke u planifikuar ndërtimi i një qendre polifunksionale ku parashikohet edhe integrimi i shërbimeve komunitare për personat me aftësi të kufizuara.

Ndërkohë, për përmirësimin e mëtejshëm të shërbimeve aktuale, rekomandohet: rritja e burimeve njerëzore dhe kapaciteteve për të përmbushur nevojat në rritje; zgjerimi i infrastrukturës së qendrave për të siguruar hapësira të mjaftueshme për ofrimin e shërbimeve intensive; përmirësimi i shërbimeve të transportit për të garantuar akses më të mirë për fëmijët dhe familjet e tyre; ofrimi i shërbimeve të tjera alternative dhe mbështetëse për adoleshentët me aftësi të kufizuara.

Implementimi i këtyre rekomandimeve do të ndihmojë në rritjen e cilësisë së shërbimeve dhe përmirësimin e mbështetjes për personat me aftësi të kufizuara në Bashkinë Vlorë.

1.3 Konsultimi i përdoruesve të shërbimit dhe i kujdestarëve të tyre në lidhje me nevojat

1.3.1 Aksesueshmërisë në institucionet e Bashkisë Vlorë

Një nga dobësitë kryesore është infrastruktura e pamjaftueshme, duke përfshirë mjediset, transportin, institucionet dhe aksesin në informacion, e cila krijon pengesa për personat me aftësi të kufizuara. Shumica e njësive administrative dhe institucioneve publike nuk janë të pajisura me rampa, parmakë, ashensorë dhe tualete të përshtatura. Ekziston gjithashtu një numër i kufizuar i burimeve njerëzore të specializuara për ofrimin e shërbimeve të nevojshme. Mungesa e diversifikimit dhe fleksibilitetit në shërbimet sociale për t'u përshtatur me nevojat e ndryshme të përdoruesve përbën një sfidë të rëndësishme. Të dhënat e vakta dhe të pamjaftueshme mbi situatën e personave me aftësi të kufizuara vështirësojnë hartimin e politikave dhe ofrimin e shërbimeve të bazuara në evidenca. Për më tepër, ekziston një mungesë e ndërgjegjësimit të profesionistëve të sektorëve të ndryshëm mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuara dhe një mungesë e mbështetjes financiare të qëndrueshme për sektorin, e cila nuk përputhet me nevojat reale.

Mundësitë

Ekziston mundësia për të aplikuar dhe përfituar nga financimet ndërkombëtare për projekte të reja që synojnë përmirësimin e shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara. Zgjerimi i bashkëpunimit me organizatat jofitimprurëse dhe përdorimi i teknologjisë dixhitale ofron mundësi për përmirësimin e shërbimeve ekzistuese dhe krijimin e shërbimeve të reja. Shfrytëzimi i kuadrit të përmirësuar politik, ligjor, rregullator dhe institucional mund të ndihmojë në përmirësimin e standardeve të shërbimeve dhe aksesueshmërisë në shërbime dhe institucione publike dhe private. Hartimi i një plani kombëtar për aftësinë e kufizuar dhe krijimi i fondit social për shërbimet sociale mund të fuqizojë më tej përpjekjet e Bashkisë në këtë drejtim.

Kërcënimet

Varësia nga burimet financiare të paqëndrueshme, qofshin ato nga fondet publike apo nga donatorët, mund të ndikojë negativisht në vazhdimësinë e projekteve dhe shërbimeve. Ndryshimet e shpeshta në politika dhe burokracia e tepruar mund të pengojnë zbatimin efektiv të projekteve dhe përmirësimin e shërbimeve. Mungesa e ndërgjegjësimit dhe sensibilizimit të vazhdueshëm në nivel lokal për të drejtat dhe nevojat e personave me aftësi të kufizuara krijon barriera për përfshirjen dhe integrimin e tyre të plotë. Prania e stigmës dhe perceptimeve negative ndaj personave me aftësi të kufizuara vazhdon të jetë një sfidë e madhe. Për më tepër, sektori jofitimprurës mbetet ende i dobët dhe i pamjaftueshëm për të vepruar si një faktor ndryshimi dhe për të ndikuar në mënyrë efektive në përmirësimin e cilësisë së jetës së personave me aftësi të kufizuara.

3. Plani lokal i veprimit për personat me aftësi të kufizuara 2025-2027

1. Qëllimi: Përmirësimi i aksesueshmërisë në mjedise, shërbime, transport dhe informacion për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara në Bashkinë Vlorë deri në fund të vitit 2027.

AKTIVITETET	AKTORËT PËRGJEGJËS	AFATI	TREGUESIT	BAZA LIGJORE	BURIMI I FINANCIMIT	KOSTO	MONITORIMI
<i>Objektivi specifik 1: Përmirësimi i nivelit dhe cilësisë së aksesueshmërisë në mjedise, transport, informacion dhe komunikim, deri në dhjetor 2027, në Bashkinë Vlorë.</i>							
Aktiviteti 1. Reduktimi i barrierave ekzistuese në mjedise. <i>Përmirësimi i aksesueshmërisë në mjedise publike për personat me aftësi të kufizuara, duke siguruar që lejet e reja dhe ekzistuese të respektojnë standardet e përshtatshmërisë.</i>	Bashkia Vlorë, Drejtoria e Ndihmës dhe Shërbimit Social Drejtoria e Urbanistikës Drejtoria Infrastrukturës dhe investimeve publike Grupet e interesit	06/2025 06/2026 12/2027	Deri në fund të vitit të parë, të gjitha ndërtimet e reja do të respektojnë standardet e aksesueshmërisë; Deri në mes të zbatimit të planit, 15-20% e mjediseve do të jenë përmirësuar; Deri në fund të planit, 20-30% e mjediseve do të jenë aksesibile	Ligji “Për aksesueshmërinë” VKM 1074, 2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikimin dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara” Ligji “Për vetëqeverisjen vendore	Bashkia Vlorë Donatorë	Pjesë e përshkrimit të punës së stafit (nuk ka kosto specifike).	Zv. Kryetaria i Bashkisë. Drejtoria e Ndihmës dhe Shërbimit Social. Grupet e interesit

Aktiviteti 2 Reduktimi i barrierave ekzistuese në transport. <i>Përmirësimi i aksesueshmërisë në sistemin e transportit për personat me aftësi të kufizuara, me fokus në kontratat e reja për shërbimet e transportit publik.</i>	Bashkia Vlorë Drejtoria e Urbanistikës	06/2026	Deri në mes të zbatimit të planit, 30-35% e rrugëve dhe mjeteve të transportit do të kenë përmirësuar aksesueshmërinë;	Ligji “Për aksesueshmërinë”, VKM 1074, 2015, Ligji “Për vetëqeverisjen vendore”.	Bashkia Vlorë Donatorë	Pjesë e përshkrimit të punës së stafit (nuk ka kosto specifike).	Zv. Kryetaria i Bashkisë. Drejtorinë e Ndihmës dhe Shërbimit Social. Grupet e interesit
	Drejtoria Infrastrukturës dhe investimeve publike Drejtoria Ndihmës dhe Shërbimit Social Grupet e interesit	12/2027	Deri në fund të planit, 40-45% e rrugëve dhe mjeteve të transportit do të kenë përmirësuar sinjalistikën dhe vendparkimet për personat me aftësi të kufizuara.				
Aktiviteti 3 Reduktimi i barrierave në informacion dhe komunikim. <i>Grupi pune me 3 specialistë të fushës ose ekspertë, secili 10 ditë me qëllim përshtatjen e të gjithë informacionit ekzistues për PAK.</i> <i>Krijimi dhe dhe shtypshkrimi i informacionit, 10 fletë informative; dhe afro 50 tabela simbolesh.</i>	Bashkia Vlorë Drejtoria Ndihmës dhe Shërbimit Social	06/2026	Deri në mes të zbatimit të planit, 15-20% e informacionit dhe komunikimit do të jenë bërë më të aksesueshëm;			Përfshin koston e dizenjimit dhe shtypjes/printimit së materialeve informative.	Zv. Kryetaria i Bashkisë. Drejtoria e Ndihmës dhe Shërbimit Social. Grupet e interesit
	Drejtoria e Informacionit dhe Marrëdhënieve me Publikun Grupet e interesit	12/2027	Deri në fund të planit, 20-25% e informacionit dhe komunikimit do të jenë përmirësuar për personat me aftësi të kufizuara.				

Aktiviteti 4 Krijimi i regjistrit të aksesueshmërisë në mjedise, transport, informacion dhe komunikim në Bashkinë Vlorë. <i>Grup pune me 3 anëtarë (20 ditë) për krijimin e regjistrit dhe rregulloren e funksionimit të tij.</i> Përcaktimi i një specialisti në drejtorinë e ndihmës ekonomike dhe shërbimeve sociale, drejtorinë e urbanistikës dhe drejtorinë e burimeve njerëzore të cilët ndër të tjera do të kenë si detyrë funksionale ndjekjen e zbatueshmërisë së kërkesave për elementët e përshtatshmërisë. <i>Hartimi/përcaktimi i qartë i detyrave funksionale të specialistëve.</i> <i>Trajnimi dy ditor i specialistëve në lidhje me rëndësinë e zbatueshmërisë së kërkesave për zbatueshmërinë e përshtatshmërisë</i>	Drejtoria e Ndihmës dhe Shërbimit Social Drejtoria e urbanistikës. Drejtoria Infrastrukturës dhe investimeve publike Drejtoria e Informacionit dhe Marrëdhënieve me Publikun Drejtoria e menaxhimit të burimeve njerëzore.	12/2025 12/2025	Regjistri i aksesueshmërisë i krijuar dhe funksional brenda vitit të parë të zbatimit të planit. Grupi punës i ngritur me detyra, përgjegjësi dhe afate. Specialistët e përcaktuar në secilën drejtori me detyra të qarta, të miratuara dhe të trajnuar deri në fund të vitit të parë të zbatimit të planit	Ligji “Për aksesueshmërinë” Ligji “Për vetëqeverisjen vendore” VKM 1074, 2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikimin dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”	Bashkia Donatorë	Kosto e krijimit dhe mirëmbajtjes së regjistrit.	Zv. Kryetaria i Bashkisë. Drejtoria e Ndihmës dhe Shërbimit Social Grupet e interesit
---	---	-------------------------------	--	--	--------------------------------	---	--

Aktiviteti 5 Zbatimi i plotë i standardeve të përshtatshmërisë për personat me aftësi të kufizuara në të paktën katër institucione publike (<i>godina e Bashkisë Vlorë, një institucion social/ kulturor, godina ku realizohet vlerësimi nga komisioni biopsikosocial dhe një shkollë 9 vjecare që ka numrin më të lartë të fëmijëve me aftësi të kufizuara</i>).	Drejtoria e Ndhmës dhe Shërbimit Social Drejtoria e urbanistikës. Drejtoria Infrastrukturës dhe investimeve publike Drejtoria e Informacionit dhe Marrëdhënieve me Publikun Drejtoria e menaxhimit të burimeve njerëzore. Grupet e interesit	06/2025 06/2025	Deri në mes të periudhës së zbatimit, dy institucione publike do të kenë zbatuar standardet e përshtatshmërisë; (<i>Institucioni i Bashkisë Vlorë & një qendër shëndetësore</i>) Deri në fund të planit, një shkolla me numrin më të madh të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe të gjitha investimet e reja do të respektojnë këto standarde.	Ligji “Për aksesueshmërinë” Ligji “Për vetëqeverisjen vendore” VKM 1074, 2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikimin dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”	Bashkia Vlorë Donatorë	Pjesë e buxhetit të bashkisë dhe fondeve të donatorëve.	Këshilli Bashkiak Zv. Kryetaria i Bashkisë. Drejtoria e Ndhmës dhe Shërbimit Social Grupet e interesit
Aktiviteti 6 Rritja e ndërgjegjësimit të komunitetit dhe trajnimi i personelit të bashkisë për zbatimin e standardeve të përshtatshmërisë. <i>Materiale informative për publikun e gjerë dhe profesionistët (dy postera, 2 fletëpalosje)</i> <i>Fushatë ndërgjegjësimi në media dhe rrjete sociale.</i>	Drejtoria e Ndhmës dhe Shërbimit Social Qendra e shërbimeve komunitare OJF-të Grupet e interesit	01/06/2025 12/2027	Deri në mes të planit, 40-rreth 50% e qytetarëve të Vlorës do të jenë të informuar për çështjet e aksesueshmërisë; Në fund të planit, mbi 80% e qytetarëve do të jenë të informuar dhe pothuaj të gjithë personat me aftësi të kufizuara do të kenë marrë informacionin e nevojshëm.	Ligji “Për aksesueshmërinë” Ligji “Për vetëqeverisjen vendore VKM 1074, 2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikimin dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”.	Bashkia, Donatorë	Përfshin koston e organizimit të fushatave të ndërgjegjësimit dhe trajnimit.	Zv. Kryetaria i Bashkisë. Drejtoria e ndihmës dhe shërbimit social Grupet e interesit

2. Përmirësimi i cilësisë së jetës për personat me aftësi të kufizuara nëpërmjet mbulimit me shërbime të diversifikuara dhe rritjes së aksesit dhe cilësisë së shërbimeve të ofruara.

AKTIVITETET	AKTORËT PËRGJEGJËS	AFATI	TREGUESIT	BAZA LIGJORE	BURIMI I FINANCIMIT	KOSTO	MONITORIMI
<i>Objektivi specifik 1: Zgjerimi i gamës dhe shtrirjes gjeografike të shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara deri në dhjetor 2027.</i>							
AKTIVITETET	AKTORËT PËRGJEGJËS	AFATI	TREGUESIT	BURIMI I TË DHËNAVE	BURIMI I FINANCIMIT	KOSTO	MONITORIMI
Aktiviteti 1							
Zhvillimi, zgjerimi dhe larmishmëria i shërbimeve në Qendrën e Shërbimeve Komunitare për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara.	Bashkia Vlorë Këshilli bashkiak Drejtorja e burimeve njerëzore	06/2026	Në mes të periudhës së zbatimit të planit, qendra komunitare ka shtuar dy specialistë/terapistë për personat me aftësi të kufizuara.	Ligji “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë” Ligji “Për vetëqeverisjen vendore	Bashkia Vlorë MSHMS/ Fondi social Donatorë	Përfshirë në buxhetin e Bashkisë dhe fondeve të donatorëve.	Këshilli Bashkiak Zv Kryetarja e Bashkisë Vlorë Grupet e interesit
<i>Zgjerimi dhe diversifikimi i shërbimeve në Qendrën e Shërbimeve Komunitare duke rekrutuar specialistë si logopedë, terapistë zhvillimi, punonjës socialë dhe specialistë të tjerë me kontratë të përkohshme, bazuar në nevojat specifike të fëmijëve</i>	Qendrën e Shërbimeve Komunitare për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara	12/2027	Në përfundim të zbatimit, qendra komunitare ka dy specialistë/terapistë të tjerë duke ofruar shërbime conform nevojave dhe standarteve të shërbimit.				
<i>Rritja e buxhetit për mjetet, materialet e punës dhe aktivitete të ndryshme sociale, kulturore dhe sportive për fëmijët.</i>		12/2027	Çdo vit, rreth 65-70 fëmijë me aftësi të kufizuara përfitojnë nga shërbimet e përmirësuara komunitare.				

Aktiviteti 2 Ofrimi i shërbimit në familje/banesë (asistencë shtëpiake). <i>Krijimi i një ekipi lëvizës multidisiplinar për të ofruar shërbim asistencë shtëpiake për personat me aftësi të kufizuara që nuk mund të frekuentojnë qendrat komunitare.</i> <i>Hartimi i procedurave standarde të veprimit dhe formateve të punës për funksionimin e këtij ekipi, bazuar në standardet e shërbimit..</i> <i>Trajnimi i stafit të ekipit lëvizës të asistencës shtëpiake për të siguruar cilësinë e shërbimit.</i>	Bashkia Vlorë Këshilli Bashkiak Drejtoria e Ndhmës dhe shërbimeve sociale	12/2027	Ekipi lëvizës i asistencës shtëpiake do të jetë ngritur dhe është funksional deri në fund të zbatimit të planit, duke ofruar shërbime për rreth 45-50 persona me aftësi të kufizuara.	Ligji “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë” Ligji “Për vetëqeverisjen vendore Udhëzim Nr. 597, datë 22.12.2017 “Për miratimin e standardeve të shërbimeve të kujdesjes shoqërore, asistencë shtëpiake, për personat me aftësi të kufizuara”. Vendim nr. 518, 04/09/2018 për “Shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial. Kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar”	Bashkia Vlorë Fondi social Donatorë	Përfshirë në buxhetin e Bashkisë dhe fondeve të donatorëve.	Zv Kryetarja e Bashkisë Vlorë Drejtorja e Ndhmës dhe Shërbimeve Sociale Qendra e Shërbimeve Komunitare për fëmijët me aftësi të Kufizuara Grupet e Interesit
---	--	----------------	--	---	--	--	--

Aktiviteti 3							
Shërbimi i ndërhyrjes së hershme.	Bashkia Vlorë	06/2026	Deri në mes të zbatimit të planit, 50% e stafit të konsultoreve, çerdheve dhe kopshteve do të jenë trajnuar për identifikimin dhe ndërhyrjen e hershme.	Ligji “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”	Bashkia	Përfshin kostot e trajnimeve dhe materialeve.	Zv. Kryetarja e Bashkisë
<i>Rritja e njohurive dhe kapaciteteve profesionale të mjekëve, infermiereve, mamive, kujdestareve në çerdhe dhe edukatoreve në kopshte mbi identifikimin e hershëm të fëmijëve me vështirësi në zhvillim dhe aftësi të kufizuara, si dhe referimin e tyre.</i>	Drejtoria e Ndihmës dhe Shërbimeve Sociale	12/2027	Në fund të zbatimit të planit, pothuajse i gjithë stafi i konsultoreve, çerdheve dhe kopshteve do të jetë i aftë të identifikojë dhe adresojë fëmijët me vështirësi në zhvillim.	Ligji “Për vetëqeverisjen vendore	Donatorët		Drejtoria e Ndihmës dhe Shërbimeve Sociale
<i>Rritja e kapaciteteve të punonjësve socialë, psikologëve dhe profesionistëve të tjerë pranë shërbime sociale, shëndetësore etj., për identifikimin, vlerësimin, ndërhyrjen dhe referimin e hershëm.</i>	Njësia Vendore e Shërbimeve Shëndetësore Vlorë		Deri në fund të vitit të parë të planit, procedurat standarde të veprimit janë hartuar, miratuar dhe zbatohen nga stafet përkatëse	Plani kombëtar i veprimit për personat me aftësi të kufizuara	Fondi social		
<i>Hartimi i procedurave standarde të shërbimit të ndërhyrjes së hershme dhe formateve të punës përkatëse.</i>	Drejtoria e burimeve njerëzore		Në fund të zbatimit të planit cerdhet dhe kopshtet kanë në stafin e tyre punonjës social dhe psikologë.		Grupet e interesit		Drejtoria e burimeve njerëzore
<i>Rekrutimi I punonjësve social dhe psikologëve në çerdhe dhe kopshte</i>	Qendra e Shërbimeve Komunitare për fëmijët me aftësi të kufizuara						

Aktiviteti 4 Krijimi i një klime dhe mjedisi të përshtatshëm për ofrimin e shërbimit të jetesës së pavarur. <i>Zhvillimi i trajnimeve të vazhdueshme me të rinj dhe të rritur me aftësi të kufizuara mbi “aftësimin për jetën” dhe jetesën e pavarur.</i> <i>Trajnimi i stafit të shërbimeve sociale në bashki mbi standardet e shërbimit të jetesës së pavarur dhe rëndësinë e integrimi të këtij shërbimi</i> <i>Informimi dhe edukimi i familjarëve dhe komunitetit mbi jetesën e pavarur për personat me aftësi të kufizuara.</i>	Drejtoria e Ndhmës dhe Shërbimeve Sociale Qendra e Shërbimeve Komunitare për fëmijët me aftësi të kufizuara Organizatrat e fushës së aftësisë së kufizuar	12/2027 12/2026 12.2027	Në fund të zbatimit të planit, fëmijët, të rinjtë dhe të rriturit me aftësi të kufizuara potencial për jetesë të pavarur do të jenë informuar dhe trajnuar për këtë shërbim. Deri në fund të vitit të dytë stafi i shërbimeve sociale zotëron njohuritë e nevojshme në lidhje me standardet e shërbimit të jetesës së pavarur dhe rëndësinë e këtij shërbimi. Deri në përfundim të planit kujdestarët, familjarët dhe komuniteti janë të informuar dhe prezantuar me shërbimin e jetesës së pavarur.	Ligji “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë” Ligji “Për vetëqeverisjen vendore	Bashkia MSHMS/ Fondi social Organizatrat në fushën e shërbimeve sociale	Përfshirë në buxhetin e Bashkisë dhe fondeve të donatorëve.	Zv Kryetarja e Bashkisë Drejtoria e Ndhmës dhe Shërbimeve Sociale OJF-të
---	--	--	---	--	--	--	---

Aktiviteti 5 Krijimi i një ekipi profesionistësh për të ofruar shërbimeve të integruara komunitare për personat e rritur me aftësi të kufizuara, pranë qendrës rezidenciale për PAK, Vlorë. Trajnimi i ekipit multidisiplinar. Zhvillimi i paketës së punës dhe procedurave standarde të veprimit të ekipit.	Bashkia Vlorë Drejtoria e Ndhmës dhe Shërbimeve Sociale Qendra e zhvillimit për persoant me aftësi të kufizuara. Grupet e interesit	12/2026	Deri në fund të vitit të dytë në bashkinë Vlorë është krijuar ekipi multidisiplinar I cili është trajnuar dhe posedon procedurat standarde për të ofruar shërbim komunitar për personat e rritur me aftësi të kufizuara.	Ligji “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë” Ligji “Për vetëqeverisjen vendore	Bashkia Vlorë MSHMS/ Fondi social Organizatrat në fushën e shërbimeve sociale		Zv. Kryeatari Drejtoria e Ndhmës dhe Shërbimeve Sociale
---	---	----------------	---	--	--	--	---

Aktiviteti 6 Përmirësimi i shërbimeve të strehimit <i>Informimi, këshillimi dhe mbështetja e personave me aftësi të kufizuara mbi kriteret e përfitimit të strehimit sipas standardeve të përshtatshmërisë.</i> <i>Zhvillimi i takimeve informuese për personat me aftësi të kufizuara mbi çështjet e strehimit.</i> <i>Përgatitja e materialeve informuese në lidhje me kriteret e përfitimit të strehimit sipas standardeve të përshtatshmërisë</i>	Drejtoria e Ndhmës dhe Shërbimeve Sociale OJF-të	2025 2026 2027	Të gjithë personat me aftësi të kufizuara në nevojë për strehim do të informohen mbi kriteret e përfitimit nga shërbimet e strehimit. Personat me aftësi të kufizuara që plotësojnë kriteret do të jenë përfitues të shërbimit të strehimit.	VKM Nr. 362, date 29.05.2019 “Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirase në tregun e lire”. VKM nr. 301, datë 15/04/2020 “Për normat e strehimit, si dhe kushtet e standardet për banesat sociale me qira që blihen në treg dhe banesat me kosto të ulët”.	Bashkia Vlorë Organizatat e fushës	Përfshirë në buxhetin e Bashkisë dhe fondeve të donatorëve.	Zv. Kryetari Këshilli Bashkiak
Aktiviteti 7 Fuqizimi dhe zhvillimi i shërbimeve për punësimin <i>Informimi dhe edukimi i punëmarrësve dhe punëdhënësve potencialë në lidhje me zbatimin e kuadrit ligjor për punësimin e personave me aftësi të kufizuara.</i> <i>Bashkëpunimi me zyrën e punës për promovimin e punësimit të personave me aftësi të kufizuara.</i>	Bashkia Vlorë Drejtoria e Ndhmës dhe Shërbimeve Sociale Zyra e punës OJF-të	06/2026 12/2027	Deri në mes të periudhës së zbatimit të planit, punësimi i personave me aftësi të kufizuara në Bashkinë Vlorë do të rritet me 20%. Në fund të zbatimit të planit, punësimi do të rritet me 40%.	Ligji 15/2019 “Për nxitjen e punësimit” Ligji “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”	Bashkia Vlorë Donatorë Organizatat e fushës	Përfshirë në buxhetin e Bashkisë dhe fondeve të donatorëve.	Bashkia Vlorë Drejtoria e Ndhmës dhe Shërbimeve Sociale Grupet e interesit.

Objektivi specifik 3: Brenda qershorit 2026 stafet e strukturave të shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara do të kenë rritur kapacitetet e profesionale për të përmbushur cilësisht detyrat funksionale

Aktiviteti 1							
Trajnimi periodik i stafit të drejtorisë së ndihmës dhe shërbimeve sociale, administratorëve shoqëror, stafit të qendrës së shërbimeve komunitare dhe profesionistëve të tjerë në lidhje me të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, kuadrin ligjor, çështje etike, dhe përdorimin e bazës së të dhënave nga vlerësimi bio-psiko-social. Zhvillimi i të paktën një cikli trajnimi tre-ditor në vit, me pjesëmarrjen e 10-15 profesionistëve, mbi temat e përmendura dhe çështje të tjera relevante.	Drejtoria e ndihmës dhe shërbimeve sociale Qendra e Shërbimeve Komunitare për fëmijët me aftësi të kufizuara OJF-të	12/2026	Praktikat e punës përmirësohen si rezultat i kapaciteteve të rritura dhe aftësive të fituara nga trajnimet.	Ligji “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë” Ligji “Për vetqeverisjen vendore”	Bashkia Vlorë, Donatorë,		Drejtoria e Ndhmës dhe Shërbimeve Sociale OJF-të.
Aktiviteti 2							
Përmirësimi i bazës së të dhënave për personat me aftësi të kufizuara nga specialisti përkatës në drejtorinë e ndihmës ekonomike dhe shërbimeve sociale.	Drejtoria e Ndhmës dhe Shërbimeve Sociale Qendra e Shërbimeve Komunitare për Aftësinë e Kufizuar Komisioni Biopsiko-social	2026	Baza e të dhënave e pasuruar me të dhëna të plota mbi PAK, shërbimet e nevojshme, shërbimet e përfutuara dhe ato të kufizuara dhe munguara për persoant me aftësi të kufizuara.	Ligji “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”	Bashkia Vlorë Donatorë		Zv. Kryetari/ja e Bashkisë Drejtoria e Ndhmës dhe Shërbimeve Sociale

Aktiviteti 3 Supervizimi periodik i ekipeve që punojnë me personat me aftësi të kufizuara, i organizuar nga drejtuesit e ekipeve, ekspertë të pavarur, organizata të shërbimeve sociale dhe Fakulteti i Shkencave Humane. Organizimi i të paktën një seance formale supervizimi çdo muaj dhe tre seanca nga ekspertë të jashtëm. Nënshkrimi i marrëveshjes me Fakultetin e Shkencave Humane, specifikisht me Departamentin e Edukimit, ku ndër të tjera do të vlerësohet mundësia që pedagogë nga ky departament të ofrojnë seanca supervizimi për stafin që punon me personat me aftësi të kufizuara në institucionet dhe shërbimet e bashkise Vlorë.	Drejtoria e Ndihmës dhe Shërbimeve Sociale, Qendra e Shërbimeve Komunitare për fëmijët me aftësi të kufizuara Qendra e zhvillimit për personat me aftësi të kufizuara Universiteti Vlorë OJFT-të	2025 2026 2027	Çdo vit, ekipet e aftësisë së kufizuar zhvillojnë të paktën një seancë formale supervizimi në muaj nga drejtuesit e ekipit dhe marrin pjesë në dy-tre seanca supervizimi në vit nga ekspertë të jashtëm. Deri në fund të vitit të parë të planit është nënshkruar marrëveshja me fakultetin e shkencave humane dhe në gjashtë mujoren e parë të vitit të dytë kanë filluar seancat e supervizimit.	Ligji “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”	Bashkia Vlorë Donatorë		Drejtoria e Ndihmës dhe Shërbimeve Sociale
---	---	-------------------------------------	--	---	--------------------------------------	--	---

Aktiviteti 4 Mbështetja dhe sigurimi me materiale burimore dhe përditësim periodik të tyre. <i>Trajnim dy ditor i të gjithë stafit që punon direkt dhe indirekt me personat me aftësi të kufizuara (rreth 15 pjesëmarrës në vitin e parë të planit) mbi identifikimin dhe prezantimin e burimeve dhe platformave online për çështjet e mbrotjes e kujdesit social përfshirë aftësinë e kufizuar. Aktiviteti trajnimit do të zhvillohet në mjediset e bashikë.</i>	Bashkia Vlorë	12/2025 12/2026 06/2027	Personat me aftësi të kufizuara marrin shërbime në përputhje me standarde, të përditësuar dhe cilësore.	Ligji “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë” Ligji “Për vetqeverisjen vendore” Dokumentet e standarteve të shërbimeve	Bashkia Donatorë Organizatat e fushës		Zv. Kryetari/ja e Bashkisë Drejtorja e Ndihmës, Shërbimeve Sociale.
---	----------------------	--	--	--	--	--	---

Aktiviteti 5 Krijimi i një faqe apo platforme online me informacion të detajuar mbi aftësinë e kufizuar dhe shërbimet përkatëse në Bashkinë Vlorë që të aksesohet nga personat me aftësi të kufizuara dhe kujdestarët e tyre.	Bashkia Vlorë Drejtoria e Ekonomisë	12/2025 12/2026 12/2026-06/2027	Ambientet e punës janë të përshtatshme për përmbushjen e detyrave funksionale dhe detyrimeve ligjore; Hartimi dhe zhvillimi i dokumentacionit dhe udhërrëfyesit të punës për shërbimet e zhvilluara. Mjedisi miqësor për personat me aftësi të kufizuara; Materiale mbështetëse dhe didaktike (ngjyra, kartona, fletore pune, plastelina, formuese etj)	Ligji “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë” Ligji “Për vetëqeverisjen vendore			
---	--	---	--	---	--	--	--

3. Sigurimi i përfshirjes së plotë të personave me aftësi të kufizuara në aktivitete publike, sportive dhe social-kulturore, duke rritur aksesin e tyre në mjediset sportive dhe kulturore dhe duke promovuar pjesëmarrjen aktive në jetën publike.

AKTIVITETET	AKTORËT PËRGJEGJËS	AFATI	TREGUESIT	BURIMI I TË DHËNAVE	BURIMI I FINANCIMIT	KOSTO	MONITORIMI
<i>Objektivi specifik 1: Rritja e aksesit në mjediset sportive dhe kulturore dhe angazhimi i personave me aftësi të kufizuara në aktivitete të ndryshme sportive dhe social-kulturore deri në dhjetor 2027.</i>							
Aktivitet 1 Garantimi i tarifave të reduktuara dhe hyrjes falas në Institucionet Sportive dhe Kulturore <i>Sigurimi i aplikimit të tarifave të reduktuara dhe hyrjes falas në institucionet sportive, kulturore dhe artistike për personat me aftësi të kufizuara.</i> <i>Hartimi dhe njoftimi i një liste të përditësuar të institucioneve që ofrojnë këto lehtësira.</i>	Këshilli Bashkiak Klubi shumësportësh Flamurtari Qendra e Kulturës Teatri Petro Marko	12/2025	Brenda vitit të parë të zbatimit të planit, është hartuar dhe njoftuar lista e institucioneve kulturore që aplikojnë tarifa të reduktuara dhe hyrje falas për personat me aftësi të kufizuara.	Ligji i aksesueshmërisë Ligji “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë” Ligji “Për vetqeverisjen vendore”	Bashkia Vlorë		Këshilli Bashkiak Grupet e interesit

Aktiviteti 2 Organizimi i Aktiviteteve Kulturore dhe Sportive për Personat me Aftësi të Kufizuara. <i>Organizimi i aktiviteteve kulturore dhe sportive periodike për personat me aftësi të kufizuara, duke përfshirë aktivitete njëditore me rreth 20 pjesëmarrës në mjediset e qendrës komunitare dhe natyrë.</i> <i>Nxitja e përfshirjes së personave me aftësi të kufizuara në aktivitete publike, sportive, kulturore dhe artistike, si dhe promovimi i këtyre aktiviteteve.</i>	Drejtoria e Ndhmës dhe Shërbimeve Sociale Qendra e Shërbimeve Komunitare Klubi shumësportësh Flamurtari Qendra e Kulturës Teatri Petro Marko Grupet e interesit OJFT-të	12/2025 12/2026 12/2027	Brenda një viti, organizohen 2-3 aktivitete kulturore dhe sportive për personat me aftësi të kufizuara.	Ligji “Për aksesueshmërinë” Ligji “Për vetëqeverisjen vendore”	Bashkia Vlorë Donatorë Organizatat fushës së aftësisë së kufizuar		Zv. Kryetari/ja Drejtoria e Ndhmës dhe Shërbimeve Sociale Grupet e interesit
---	---	--	---	--	--	--	---

Aktiviteti 3 Informimi i personave me aftësi të kufizuara mbi aktivitetet publike, sportive dhe kulturore. <i>Informimi i personave me aftësi të kufizuara në kohë dhe në mënyrë të përshtatshme për të gjitha aktivitetet publike, sportive, kulturore dhe artistike që organizohen në Bashkinë Vlorë.</i> <i>Klubet dhe institucionet përkatëse njoftojnë Drejtorinë e Ndihmës Ekonomike dhe Shërbimeve Sociale, njësitë administrative dhe qendrën komunitare për personat me aftësi të kufizuara për kalendarin e aktiviteteve.</i>	Drejtoria e Ndihmës dhe Shërbimeve Sociale Drejtoria e Informacionit dhe Marrëdhënieve me Publikun Qendra e Shërbimeve Komunitare për fëmijët me aftësi të kufizuara. Grupet e interesit OJFT-të	2025 2026 2027	Informacioni për aktivitetet është i aksesueshëm në faqen elektronike dhe rrjetet sociale të Bashkisë Vlorë. Organizatat e fushës janë të informuara në kohë për kalendarin e aktiviteteve.	Ligji “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë” Ligji “Për vetqeverisjen vendore”	Bashkia Vlorë		Bashkia Vlorë Këshilli Bashkiak
--	---	-------------------------------------	---	--	----------------------	--	---

Aktiviteti 4 Përfshirja e Personave me Aftësi të Kufizuara në Proceset e Vendimmarrjes Publike. <i>Sigurimi i informimit dhe përfshirjes së personave me aftësi të kufizuara si grup interesi me të drejta të plota në dëgjesat publike për hartimin e reformave dhe politikave sociale, shëndetësore, arsimore dhe të punës.</i> <i>Informimi i tyre në kohë dhe në mënyrë të përshtatshme për proceset e hartimit të dokumenteve politike dhe takimet e Këshillit Bashkiak.</i>	Drejtoria e Ndihmës dhe Shërbimeve Sociale Drejtoria e Informacionit dhe Marrëdhënieve me Publikun Njësitë administrative Qendra komunitare për personat me aftësi të kufizuara OJFT-të Grupet e Interesit	2025 2026 2027	Informacioni për takimet dhe dëgjesat publike është i aksesueshëm në faqen elektronike dhe rrjetet sociale të Bashkisë Vlorë. Organizatat e fushës janë të informuara në kohë për kalendarin e takimeve të Këshillit Bashkiak.	Ligji për Informimin dhe Konsultimin Publik.	Bashkia Rrjeti i organizatave të personave me aftësi të kufizuara Organizatat e prindërve të personave me AK intelektuale		Zv.Kryeatari/ja Drejtoria e Ndihmës dhe Shërbimeve Sociale OJFT-të Grupet e interesit
--	--	-------------------------------------	--	---	--	--	---

4. Sigurimi i një bashkëpunimi efektiv ndërmjet institucioneve dhe sektorëve të ndryshëm për të garantuar të drejtat dhe shërbimet për personat me aftësi të kufizuara, duke përmirësuar koordinimin dhe efikasitetin e përgjigjes institucionale.

AKTIVITETET	AKTORËT PËRGJEGJËS	AFATI	TREGUESIT	BURIMI I TË DHËNAVE	BURIMI I FINANCIMIT	KOSTO	MONITORIMI
Objektivi specifik 1: Përmirësimi i bashkëpunimit ndërmjet institucioneve dhe organizatave të sektorit publik dhe jopublik që lidhen direkt dhe indirekt me fushën e aftësisë së kufizuar deri në dhjetor 2027.							
Aktiviteti 1.							
Vendosja e marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucionet relevante. <i>Hartimi dhe nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucionet që posedojnë të dhëna për identifikimin, vlerësimin dhe referimin e personave me aftësi të kufizuara.</i> <i>Përgatitja e formatit të marrëveshjeve të bashkëpunimit nga një grup pune me të paktën dy anëtarë (specialist i aftësisë së kufizuar dhe zyra juridike e bashkisë).</i> <i>Organizimi i tre takimeve periodike (një në vit) për monitorimin e zbatimit të marrëveshjeve.</i>	Drejtoria e Ndhmës dhe Shërbimeve Sociale Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, Operatori Rajonal Shëndetësor, Drejtoria Rajonale Arsimore, Drejtoria Rajonale e Punësimit Organizatrat e Fushës	06/2026	Marrëveshjet e bashkëpunimit janë nënshkruar dhe zbatohen me institucionet përkatëse: Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, Operatori Rajonal Shëndetësor, Drejtoria Rajonale Arsimore, Drejtoria Rajonale e Punësimit dhe organizatat jofitimprurëse	VKM Nr. 411, Datë: 19.06.2019, Për disa ndryshime në Vendimin nr. 708, datë 26.8.2015, i Këshillit të Ministrave, "Për llojet, periodicitetin dhe mënyrën e raportimit të të dhënave statistikore për aftësinë e kufizuar nga strukturat shtetërore përgjegjëse, në nivelin qendror dhe lokal" Ligji "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë" Ligji "Për vetëqeverisjen vendore" Ligji "Për të drejtën e informimit publik" Reforma e vlerësimit të aftësisë së kufizuar në sistemin e mbrojtjes sociale Paketa bazë e shërbimeve të kujdesit shëndetësor parësor	Bashkia Vlorë Donatorë		Zv. Kryetari/ja e Bashkisë Drejtoria e Ndhmës Ekonomisë dhe Shërbimeve Sociale

Aktiviteti 2. <i>Hartimi i një rregulloreje/ udhëzuesi për bashkëpunimin ndërmjet institucioneve për formën e bashkëpunimit, afatet kohore dhe modalitete të tjera të nevojshme.</i> <i>Zhvillimi i tryezave të rrumbullakëta për të diskutuar dhe dakordësuar me institucionet për formatet e të dhënave për aftësinë e kufizuar dhe modalitetet e bashkëpunimit.</i>	Drejtoria e Ndihmës dhe Shërbimeve Sociale Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, Operatori Rajonal Shëndetësor, Drejtoria Rajonale Arsimore, Drejtoria Rajonale e Punësimit Organizatrat e Fushës	06/ 2026	Rregullorja e bashkëpunimit dhe modalitetet e bashkëpunimit ndërsektorial janë hartuar dhe miratuar, përfshirë formatet e të dhënave dhe personat përgjegjës. Të dhënat mbledhen dhe shkëmbehen në kohë dhe me cilësi të lartë nga të gjithë sektorët përkatës.	Ligji “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë” Ligji “Për vetqeverisjen vendore Ligji “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve”	Bashkia Vlorë		Zv. Kryetari/ja Bashkisë Drejtoria e Ndihmës dhe Shërbimeve Sociale
Aktiviteti 3 Analiza periodike ndërsektoriale për çështjet e aftësisë së kufizuar <i>Organizimi i takimeve të përvitshme ndërsektoriale për të diskutuar dhe analizuar çështjet e aftësisë së kufizuar me përfaqësuesit e institucioneve partnere.</i> <i>Zhvillimi i analizave vjetore të të dhënave dhe veprimtarive për personat me aftësi të kufizuara.</i>	Drejtoria e Ndihmës dhe Shërbimit Social Qendra ditore PAK Qendra rezidenciale për PAK, Vlorë. Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, Operatori Rajonal Shëndetësor, Drejtoria Rajonale Arsimore, Drejtoria Rajonale e Punësimit Organizatrat e Fushës	2025 2026 2027	Çdo vit organizohet mbledhja/takimi me përfaqësues të institucioneve nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale. Minutat e takimit/ raporti vjetor i analizës	Ligji “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë” Ligji “Për vetqeverisjen vendore”	Bashkia Vlorë		Zv Kryetari/ja i Bashkisë Drejtoria e Ndihmës Ekonomisë dhe Shërbimeve Sociale

5. Sigurimi i zbatimit efektiv dhe monitorimit të vazhdueshëm të Planit Lokal për Personat me Aftësi të Kufizuara (PLSPAK) për të garantuar përmbushjen e qëllimeve dhe objektivave të tij.

AKTIVITETET	AKTORËT PËRGJEGJËS	AFATI	TREGUESIT	BURIMI I TË DHËNAVE	BURIMI I FINANCIMIT	KOSTO	MONITORIMI
Objektivi specifik 1: PLSPAK do të promovohet dhe zbatohet me efikasitet dhe efektivitet deri në dhjetor 2027, duke mbuluar të gjitha qëllimet, objektivat dhe aktivitetet e planifikuara.							
Aktiviteti 1 Përshtatja e PLSPAK për të gjitha kategoritë e aftësisë së kufizuar <i>Përshtatja e PLSPAK në formate të duhura për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara, duke përfshirë formate audio dhe Braille.</i> <i>Angazhimi i dy ekspertëve të jashtëm për të hartuar dhe përshtatur dokumentin e planit në formatet e nevojshme.</i> <i>Sigurimi i mjeteve didaktike dhe teknike për përshtatjen e dokumentit.</i>	Drejtoria e Ndhmës dhe Shërbimeve Sociale Drejtoria e informacionit dhe marrëdhënieve me publikun Grupet e interesit OJF-të.	06.2025	Tre deri gjashtë muaj pas miratimit, PLSPAK është në formate të përshtatura për të gjithë personat me aftësi të kufizuara.	Ligji “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë” Ligji për aksesueshmërinë Ligji “Për vetëqeverisjen vendore.	Bashkia Vlorë Donatorë OJF-të Grupet e interesit Fondi Social		Zv Kryetari i Bashkisë Drejtoria e Ndhmës dhe Shërbimeve Sociale
Aktiviteti 2 Prezantimi i Planit Social të PAK tek Aktorët e Ndryshëm. <i>Organizimi i një aktiviteti prezantues për PLSPAK me pjesëmarrjen e institucioneve, organizatave dhe personave me aftësi të kufizuara.</i> <i>Publikimi i PLSPAK në faqen e internetit të Bashkisë Vlorë dhe shpërndarja e tij në formë zyrtare dhe elektronike tek aktorët relevantë.</i>	Drejtoria e Ndhmës dhe Shërbimeve Sociale	06/2025	PLSPAK është prezantuar dhe shpërndarë tek të gjithë aktorët relevantë dhe është publikuar në faqen zyrtare të Bashkisë.	Ligji “Për vetëqeverisjen vendore	Bashkia Vlorë Donatorë OJF		Zv Kryetari i Bashkisë

Aktiviteti 3 Zbërthimi i Planit në Aktivitete më të Detajuara <i>Zbërthimi i PLSPAK në aktivitete të detajuara njëvjeçare, gjashtëmujore dhe tremujore për të siguruar zbatimin e saktë dhe të planifikuar të tij.</i> <i>Formimi i një grupi pune me përfaqësues nga sektorë të ndryshëm për ndjekjen e zbatimit të planit dhe marrjen e masave të nevojshme.</i>	Drejtoria e Ndhmës dhe Shërbimeve Sociale	2025	Planet periodike janë miratuar dhe të gjithë aktorët janë njoftuar me detyra të qarta dhe afate përkatëse për zbatimin e aktiviteteve.	Ligji “Për vetqeverisjen vendore Ligji “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”	Bashkia Vlorë OJF Donatorë		Zv. Kryetari/ja e Bashkisë Drejtoria e Ndhmës dhe Shërbimeve Sociale
	Drejtoria e Burimeve Njerëzore	2025					
	Drejtoria e Urbanistikës	2026					
	Drejtoria e Infrastrukturës dhe investimeve publike	2027					
Aktiviteti 4 Monitorimi periodik i planit të veprimit. <i>Realizimi i analizës vjetore të zbatueshmërisë së planit dhe diskutimi i rezultateve me aktorët relevantë.</i> <i>Raporti i vlerësimit periodik prezantohet në Këshillin Bashkiak dhe u dërgohet institucioneve dhe organizatave përkatëse për feedback dhe rishikim të mundshëm.</i>	Drejtoria e Ndhmës dhe Shërbimeve Sociale	2025	Raportet e monitorimit janë konsultuar dhe njohur nga të gjithë aktorët e përfshirë.	Ligji “Për vetqeverisjen vendore Ligji “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”	Bashkia Donatorë		Këshilli Bashkiak Zv. Kryetarja Bashkisë
	Qendra ditore PAK	2025					
	Qendra rezidenciale PAK	2026					
	Drejtoria e Burimeve Njerëzore						
	Drejtoria e Urbanistikës						
	Drejtoria e Infrastrukturës dhe investimeve publike						
	Drejtoria informacionit dhe marrëdhënieve me publikun						
	OJF-të						
	Grupet e interesit						

Referenca

- Ligji nr.108/2012 datë 15.11.2012 “Për ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara””
- Ligji nr. 93/2014, datë 24.7.2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”
- VKM Nr. 1074, datë 23.12.2015, “Për masat për heqjen e pengesave mjedisore dhe të infrastrukturës në ofrimin e shërbimeve publike”
- VKM Nr. 411, Datë: 19.06.2019, Për disa ndryshime në Vendimin nr. 708, datë 26.8.2015, i Këshillit të Ministrave, “Për llojet, periodicitetin dhe mënyrën e raportimit të të dhënave statistikore për aftësinë e kufizuar nga strukturat shtetërore përgjegjëse, në nivelin qendror dhe lokal”
- VKM nr. 874, datë 24.12.2019 “Për mënyrën e ofrimit të ndihmës personale dhe kriteret për zgjedhjen e ndihmës personal”.
- VKM nr. 85, datë 08.02.2017 “Për përcaktimin e rregullave për prodhimin shpërndarjen dhe pajisjen e udhëtarëve me bileta transporti rrugor”
- Ligj nr. 7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit” të ndryshuar;
- Ligj nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për statusin e të verbrit”, të ndryshuar;
- Ligj nr. 8626, datë 22.06.2000 “Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar;
- VKM nr. 182, datë 26.02.2020 “Për përcaktimin e masës, të kriterëve, procedurave e dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e pagesës për personat me aftësi të kufizuara, si dhe të ndihmës personal”, të ndryshuar;
- VKM nr. 722, datë 11.11.2019 “Për përcaktimin e masës, të kriterëve, procedurave e dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e aftësisë së kufizuar e të ndihmës personal dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre”;
- VKM Nr. 56, datë 31.1.2018 “Për përcaktimin e kategorive konkrete të grupeve të pafavorizuara”
- Udhëzim i Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Nr. 597, datë 22.12.2017 “Për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore, asistencë shtëpiake, për personat me aftësi të kufizuara”.
- VKM Nr. 362, date 29.05.2019 “Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirase ne tregun e lire”.
- VKM Nr. 454, date 03.07.2019 “Për kriteret dhe procedurat e përfitimit të dhënies së granteve konkurruese për përmirësimin e kushteve të objekteve dhe banesave ekzistuese”.